



Borxhet

Kur njeriu nuk i paguan faturat rregullisht, mundet me pas konsekuenca serioze. Te problemet financiare, ofrojnë mbështetje qendrat këshilluese për borxhe.

Vërejtjet dhe mbledhja e borxhit

Kush nuk e paguan një faturë me kohë, e merr në rastin normal një vërejtje të parë dhe të dytë (Mahnung|Rappel). Kreditorët e kanë mundësinë në çdo kohë, të bëjnë në zyrën e përmbaruesit një paraqitje për mbledhje të borxhit (Betreibung|Poursuite). Në këtë rast merr borxhlikja apo borxhliu një urdhër për pagesë nga zyra përgjegjëse e përmbaruesit për borxhlinjë (Betreibungsamt | Office des poursuites). Me këtë shtohen taksat. Kush është i mendimit, se nuk është e drejtë mbledhja e borxhit ndaj tij, mundet me një person për drejtësi (Rechtsvorschlag | Opposition) të mbrohet te zyra e përmbaruesit për mbledhjen e borxhit. Kujdes: Kjo zyrë mundet me bërë sekuestrimin e rrogës apo të gjërave me vlerë. Përveç kësaj borxhet regjistrohen në regjistrin për borxhe te përmbaruesi (edhe kur njeriu në fund ka paguar). Kjo mundet ndër të tjera të paraqes problem gjatë kerkimit të punës apo banesës.

Borxhet

Kush ka brengë apo borxhe, mundet me u drejtue në zyrën për këshillime për borxhe (Schuldenberatungsstelle | conseil en matière de dettes). Aty njeriut i ofrohet mbështetje. Ekspertët shikojnë së bashku me kërkuesin për këshillim situatën dhe kërkojnë një zgjidhje. Për banoret dhe banorët në kantonin e Bernit, ka këshillimore rajonale falas (Berner Schuldenberatung, Centre social protestant / CSP). Organizata Karitas ofron një këshillim anonim falas përmes telefonit dhe internetit. Sipas nevojës ndërlihet njeriu me një vend tjetër këshillues.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/parat-dhe-tatimi/borxhet